

VENDIM
Nr.776, datë 4.6.2008

PËR SHPALLJEN “ZONË EKONOMIKE”, NË ELBASAN

(Ndryshuar me vendimin nr. 797, datë 16.11.2011)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.9789, datë 19.7.2007 “Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike”, me propozimin e Ministrisë të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e zonës ekonomike, me statusin “Park industrial”, të sipërfaqes 254.7 (dyqind e pesëdhjetë e katër pikë shtatë) ha, pjesë e zonës kadastrale nr.3965, Elbasan.

2. Shtrirja dhe kufizimet e kësaj zone përcaktohen në hartën treguese, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Në këtë zonë ekonomike do të zhvillohen veprimtari:

- prodhuese, industriale;
- shërbimi;
- tregtare;
- import-eksporti.

4. Periudha e funksionimit të zonës është 35 vjet.

5. Sipërfaqja prej 188.4 (njëqind e tetëdhjetë e tetë pikë katër) ha, pronësi shtetërore e zonës ekonomike, jepet me koncesion.

6. Procedura e përzgjedhjes së zhvilluesit të zonës bëhet në mbështetje të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”.

6.1. Në rast të mungesës së interesit për dhënien me koncesion të kësaj zone, objektet pronë shtetërore, që ndodhen të lira brenda kësaj sipërfaqeje, i nënshtrohen procedurës së privatizimit

7. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

